



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT**  
**AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE**  
**KUALIFIKIMEVE**

**PROGRAM ORIENTUES PËR PROVIMIN E**  
**MATURËS SHTETËRORE PROFESIONALE**

**TEORIA PROFESIONALE E INTEGRUAR:**  
**KUALIFIKIMI PROFESIONAL “SHËRBIME BANKARE”**

**(Niveli IV në KSHK, referuar Niveli IV në KEK)**

**Tiranë, 2024**

## 1. Udhëzime të përgjithshme

Ky program orientues ndihmon në përgatitjen e nxënësve për Kualifikimin Profesional “**Shërbime bankare**”, me strukturë 2+2, për provimin e detyruar “Teori profesionale e integruar” të Maturës Shtetërore Profesionale. Ai synon orientimin e përgatitjes së nxënësve nëpërmjet përqendrimit në njohuritë dhe aftësitë më të rëndësishme të lëndëve teorike profesionale. Njëherazi, ndihmon edhe në verifikimin paraprak të përgatitjes përfundimtare të nxënësve sepse mundëson zhvillimin e testeve përmbledhëse. Programi orientues për provimin e “Teorisë profesionale të integruar” bazohet në:

- Programet e lëndëve teorike profesionale të Kualifikimit Profesional “Ekonomi-Biznes”, Niveli II i KSHK-së (klasa e 10-të dhe 11-të);
- Programet e lëndëve teorike profesionale të Kualifikimit Profesional “Shërbime bankare”, Niveli IV i KSHK-së (klasa e 12-të dhe 13-të).
- Udhëzimin e përbashkët të MAS dhe MFE nr. 27, datë 12.12.2023 “Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore dhe Maturës Shtetërore Profesionale 2024”.

Në të përfshihen njohuritë dhe aftësitë më të rëndësishme të këtyre programeve dhe që janë në themel të formimit teorik profesional të nxënësit.

## 2. Udhëzime për zbatimin e programit

Ky program duhet shqyrtuar me kujdes sepse evidenton dhe përforcon njohuritë teorike, por dhe aftësitë e nxënësve për aplikimin e njohurive në situata të njohura e të reja, analizën dhe vlerësimin e këtyre situatave. Specialistët e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe tezës së provimit të “Teorisë profesionale të integruar”, nuk duhet të përfshijnë për vlerësim tema mësimore që nuk janë parashikuar në këtë program. Përgatitja e nxënësve për provim të bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe duke përdorur një larmi metodash dhe mjetesh.

Qëllimi i provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale është vlerësimi i të nxënësit dhe arritjeve si dhe përzgjedhjen e nxënësve për arsimim të mëtejshëm.

Gjatë punës për përgatitjen e nxënësve për provimin e detyruar “Teori profesionale të integruar” të Maturës Shtetërore Profesionale, është e rëndësishme që herë pas here mësuesi të zhvillojë teste të nxënësve të tij, me teste që mund t’i hartojë vetë duke u bazuar në modelet e mëparshme të testeve të Maturës Shtetërore për teorinë profesionale.

Testi për Kualifikimin Profesional “**Shërbime bankare**” do të ndërtohet në mënyrë të tillë ku të jenë të përfshira të tri nivelet e vështirësisë: niveli bazë, niveli mesatar dhe niveli i lartë.

Njëkohësisht, edhe shpërndarja e pikëve në test do të jetë në varësi të përqindjeve që zë çdo nivel. Gjatë hartimit të njësive të testit duhet të mbahen parasysh synimet e përgjithshme, në skeletkurrikulat përkatëse, të temave të përzgjedhura në këtë program.

Ky program përmban rreth **30%** të vëllimit të përgjithshëm të lëndëve të kulturës profesionale. Në këtë program janë përfshirë ato lëndë, të cilat përbëjnë bazën kryesore dhe thelbësore për formimin profesional të nxënësve.

Nxënësit duhet të kenë parasysh se lënda, e cila ka peshën më të madhe në këtë program orientues të Maturës Shtetërore Profesionale, në test do të përfaqësohet nga një numër më i madh pyetjesh.

### 3. Lëndët dhe temat përkatëse

Në programin orientues të provimit të “**Teorisë profesionale të integruar**” në kuadrin e provimit të detyruar “Teori profesionale e integruar”, të Maturës Shtetërore Profesionale, për Kualifikimin Profesional “**Shërbime bankare**“, do të përfshihen programet e lëndëve profesionale të mëposhtëme:

1. Njohuri në Mikroekonomi kl. 10
2. Njohuri në Makroekonomi kl. 11
3. Bankat dhe sistemi financiar kl. 12
4. Teknika bankare kl. 12 dhe kl. 13
5. Kontabiliteti bankar kl. 13

**Tabela 1: Lëndët profesionale** të përfshira në programin orientues dhe peshat e tyre përkatëse janë si më poshtë, duke konsideruar vëllimin dhe rëndësinë e tyre në formimin profesional të nxënësve.

Nr	Lëndët	Vëllimi i orëve për çdo lëndë	Peshat në %
1	Njohuri në Mikroekonomi	44	14
2	Njohuri në Makroekonomi	20	6
3	Bankat dhe sistemi financiar	38	12
4	Teknika bankare	141	46
5	Kontabiliteti bankar	66	22
	<b>TOTALI</b>	<b>309</b>	<b>100%</b>

**Temat sipas lëndëve janë:**

<b>1) “Njohuri në Mikroekonomi”, kl. 10:</b>	<b>(44 orë)</b>	
• Kërkesa, oferta, funksionimi i tregjeve dhe ekuilibri i tyre		20 orë
• Prodhimi, kostot, të ardhurat dhe fitimi i ndërmarrjes		24 orë
<b>2) “Njohuri në Makroekonomi”, kl. 11:</b>	<b>(20 orë)</b>	
• Paraja dhe institucionet financiare		10 orë
• Inflacioni, papunësia dhe ciklet e biznesit		10 orë
<b>3) “Bankat dhe sistemi financiar”, kl. 12:</b>	<b>( 38 orë)</b>	
• Bankat, sistemi bankar dhe tipologjia		6 orë
• Struktura e sistemit bankar shqiptar		8 orë
• Banka e Shqipërisë		8 orë
• Zhvillimi i sistemit bankar në Shqipëri		6 orë
• Menaxhimi i burimeve njerëzore në bankë		10 orë
<b>4) “ Teknika bankare”, kl.12 dhe kl.13:</b>	<b>(141 orë)</b>	
• Aktiviteti bankar dhe funksionet e tij		10 orë
• Klasifikimi i operacioneve bankare dhe i rreziqeve		6 orë
• Depozitat e kursimit		10 orë
• Llogaritë rrjedhëse		16 orë
• Shërbimet e pagesave dhe të transferimit të parave		16 orë
• Kredidhënia bankare		10 orë
• Kushtet e kredidhënies		14 orë
• Llojet e kredive		20 orë
• Shërbime të tjera bankare		9 orë
• Tregu i letrave me vlerë dhe kuotimi i instrumenteve financiare		10 orë
• Veprimtaria në valutë e bankave		12 orë
• Tregjet financiare ndërkombëtare		8 orë
<b>5) “ Kontabiliteti bankar”, kl.13:</b>	<b>(66 orë)</b>	
• Llogaritje të thjeshta të shpërndarjeve, përqindjeve, interesave, skontove		4 orë
• Struktura pasurore, e detyrimeve të bankës dhe bilanci bankar		4 orë
• Struktura e shpenzimeve bankare		4 orë
• Bazat ligjore mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit bankar dhe plani i llogarive bankare		2 orë
• Struktura dhe organizimi i kontabilitetit sintetik dhe analitik bankar		4 orë
• Veprimet dhe kontabilizimet e çeljes së llojeve të ndryshme të llogarive të klientëve		4 orë

- Kontabilizimet e derdhjeve dhe pagesave me para në dorë në llogaritë rrjedhëse të klientëve 4 orë
- Veprimet dhe kontabilizimet me llogaritë e depozitave 10 orë
- Inventarizimi dhe kuadrimi ditor i arkës dhe sistemimi i diferencave 4 orë
- Llogaritja dhe kontabilizimi i interesave të llogarive rrjedhëse 4 orë
- Regjistrimet kontabël të akordimit të llojeve të ndryshme të kredive 4 orë
- Llogaritja e interesave të kredive dhe kontabilizimi i tyre. Shlyerja tërësore ose me këste e kredive 4 orë
- Llogaritja dhe regjistrimi i shpenzimeve të tjera bankare 4 orë
- Llogaritja e kostove, kontabilizimet dhe pasqyrimi i rezultateve pjesore sipas funksioneve të bankës 4 orë
- Hartimi i bilanceve të thjeshta ditore dhe vjetore 6 orë